



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË
DEGA VENDORE TIRANË

NOTER ALKET Z. MANÇKA
ADRESA NR.2, ASIM ZENELI, NR.10,
NR.6
TEL: 693645101

PËRPILIM DHE VËRTETIM TË SH.P.K.-VE

(AKT THEMELIMI DHE STATUT)

Nr. repertori: 4127

Nr. koleksioni: 2152

Tirane më 06/06/2023

Ligjet referuese:

- 1.Ligji nr. 7850, datë 29/07/1994 "Kod i Civil i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar
- 2.Ligji nr. 9887, date 10/03/2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar
- 3.Ligji nr. 110, datë 20/12/2018 "Për Noterinë", i ndryshuar

*Akti noterial për bëhet nga 6 fletë



A2023051400217642723



A2023051400217642733

AKTI I THEMELIMIT dhe STATUTI

SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR “ARMEN SOLAR SH.P.K.”

Sot më datë 06 / 06 /2023, para meje Noter ALKET Z. MANÇKA, anëtar në Dhomën Kombëtare të Noterisë, Dega Vendore TIRANË, me zyrë në adresën: Tiranë, Nr.2, Asim Zeneli, Nr.10, Nr.6, u paraqitën palët e mëposhtme:

1. **Shoqëria BLESSED INVESTMENT SH.P.K.**, një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar e themeluar në përputhje me ligjet e Republikës së Shqipërisë, e regjistruar në Regjistrin Tregtar shqiptar mbajtur nga Qendra Kombëtare e Biznesit me NUIS L71423028S, me seli në adresën: Njësia Bashkiake Nr. 2, Rruga “Themistokli Gërmenji”, Nd. 1, Tiranë, Shqipëri, e përfaqësuar nga Administratori i saj Znj. Ana Lleshi, shtetase shqiptare, e bija e Bashkim-it, lindur më 07/05/1981, në Tiranë dhe banuese në Tiranë, mbajtëse e letërnjoftimit ID me Nr. 036384557 dhe Nr.personal I15507055G, madhore dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar;
2. **MATRIX KONSTRUKSION SH.P.K.**, një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar e themeluar në përputhje me ligjet e Republikës së Shqipërisë, e regjistruar në Regjistrin Tregtar shqiptar mbajtur nga Qendra Kombëtare e Biznesit me NUIS J91306009Q, me seli në adresën: Njësia Bashkiake Nr.7, Rruga “Nikolla Jorga”, Godina Nr. 18/2, Tiranë, Shqipëri, e përfaqësuar nga Administratori i saj Znj. Ida Mezini, shtetase shqiptare, e bija e Shefit-it, lindur më 24/07/1971, në Berat, banuese në Tiranë, mbajtëse e letërnjoftimit ID me Nr. 036980443 dhe Nr. personal H15724048V, madhore dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar;
3. **Znj. Borana Gusho**, shtetase shqiptare, atësia Frederik, lindur më 10/06/1984, në Tiranë, banuese në Tiranë, në adresën: Rruga “Prokop Myzeqari”, Hyrja 1, Apartamenti 4, mbajtëse e letërnjoftimit ID me Nr. 038142754 dhe Nr. personal I45610083J, madhore dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar;
4. **Znj. Vasillo Kuro**, shtetase shqiptare, atësia Jorgji, lindur më 10/11/1962, në Ksamil, banuese në Tiranë, në adresën: Rruga “Liman Kaba”, Nd. 38, H. 8, Ap. 4, Njësia Administrative Nr. 5, 1019, mbajtëse e letërnjoftimit ID me Nr. 036473948 dhe Nr.personal G26110018G, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar;

të cilët kanë vendosur të nënshkruajnë Aktin e Themelimit të mëposhtëm të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar, aktiviteti i së cilës rregullohet nga legjislacioni shqiptar në fuqi dhe Statuti i saj, i cili është pjesë përbërëse e këtij akti dhe i bashkëngjitet si Shtojca A.

Neni 1 – Emërtimi

Shoqëria emërtohet **Armen Solar Sh.p.k.** (në vijim referuar si “**Shoqëria**”).

Neni 2 – Selia

Selia e Shoqërisë është në adresën: Njësia Bashkiake Nr. 2, Rruga “Themistokli Gërmenji”, Ndërtesa 1, Tiranë, Shqipëri.

Neni 3 – Kohëzgjatja e veprimtarisë

Kohëzgjatja e Shoqërisë do të jetë me një afat të pacaktuar.



A202305140017642733

Neni 4 – Objekti i Shoqërisë

Objekti i veprimtarisë së Shoqërisë do të përfshijë, por nuk do të kufizohet vetëm në: Ushtrimin e veprimtarive tregtare në fushën e zhvillimit dhe prodhimit të energjisë elektrike nga burimet e rinovueshme, studim, projektim, zbatim, ndërtim, instalim, komisionim, financim, operim, prodhim dhe tregtim i energjisë elektrike nga burime të rinovueshme, si parqet e erës (eolike), ujore, sistemet fotovoltaike, termocentralet, biomasa, etj. dhe infrastrukturat shërbyese.

Përveç sa më sipër, Shoqëria mund të kryejë çdo aktivitet që lidhet direkt ose indirekt, që është rezultat ose lidhet me objektivin e mësipërm, siç mund të konsiderohet i nevojshëm apo i dobishëm apo ndihmës në përmbushjen e qëllimeve të mësipërme.

Gjithashtu, për arritjen e qëllimeve të mësipërme, Shoqëria mund të kryejë çdo aktivitet të ligjshëm tregëtar që lidhet me çfarëdolloj pasurie të luajtshme dhe/ose të paluajtshme, duke përfshirë por pa u kufizuar vetëm në blerjen, shitjen, transferimin, ndërtimin, nënkontraktimin, disponimin, posedimin, menaxhimin, marrjen apo dhënien me qira, *leasing* e pasurive të luajtshme dhe/ose të paluajtshme, dhënien e fitimit e çdo të drejte apo privilegji në lidhje me këto pasuri, dhe çdo aktivitet tjetër tregëtar, financiar, qeraje ose hipoteke, që mund të konsiderohet i vlefshëm ose i nevojshëm në mënyrë që të ushtrohet objekti i Shoqërisë.

Së fundi, Shoqëria mund të kryejë çdo operacion tregëtar që lidhet me burimet e rinovueshme të energjisë elektrike, operacione financiare dhe kredimarrje, të japë garanci të tretëve, si edhe të ketë pjesëmarrje në shoqëri, ente, konsorciume, të themeluara apo në themelim e sipër, që kanë objekt të njëjtë ose të ngjashëm me të vetin apo gjithësesi funksional për arritjen e qëllimeve të Shoqërisë. Më në përgjithësi, Shoqëria mund të kryejë çdo aktivitet tjetër të nevojshëm apo të dobishëm të lejuar nga ligji për realizimin e qëllimeve të Shoqërisë.

Neni 5 – Kapitali i Shoqërisë, kontributet dhe kuotat

Kapitali themeltar fillestar i Shoqërisë është 100,000 (njëqind mijë) Lekë. Pjesëmarrja e themeluesve në kapitalin e Shoqërisë është në përputhje me kontributet e tyre të mëposhtme:

1. Ortaku themelues Blessed Investment Sh.p.k.: Zotërues i 1 (një) kuote me vlerë të përgjithshme 30,000 Lekë që përbën 30% të kapitalit themeltar të Shoqërisë;
2. Ortaku themelues Matrix Konstruksion Sh.p.k.: Zotërues i 1 (një) kuote me vlerë të përgjithshme 30,000 Lekë që përbën 30% të kapitalit themeltar të Shoqërisë;
3. Ortaku Themelues Znj. Borana Gusho: Zotërues i 1 (një) kuote me vlerë të përgjithshme 20,000 Lekë që përbën 20% të kapitalit themeltar të Shoqërisë;
4. Ortaku Themelues Znj. Vasillo Kuro: Zotërues i 1 (një) kuote me vlerë të përgjithshme 20,000 Lekë që përbën 20% të kapitalit themeltar të Shoqërisë.

Neni 6 – Transferimi i kuotave

Kuotat transferohen sipas parashikimeve të Statutit.

Neni 7 – Administrimi

Administrator i Shoqërisë do të jetë:

Z. Altin Mihali, shtetas shqiptar, atësia Argjir, lindur më 27/01/1972, në Kuçovë, banues në Tiranë, në adresën: Rruga “Tom Plezha”, Pallati “Fildish”, Hyrja 3, Ap. 9, mbajtës i pasaportës me Nr. BF1395624 dhe Nr. personal H201270451, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar.

Administratori emërohet me vendim të Ortakëve dhe qëndron në këtë detyrë për një afat jo



A2023051400217642723

më të gjatë se 5 (pesë) vjet. Administratori mund të rizgjidhet për të njëjtën periudhë me vendim të Ortakëve të Shoqërisë.

Administrimi i Shoqërisë do të kryhet nga Administratori i Vetëm, me përjashtim të rastit kur Statuti e parashikon ndryshe.

Administratori ka të drejtë të kryejë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të Shoqërisë, duke zbatuar politikën tregtare, të vendosura nga Asambleja e Përgjithshme në përputhje me dispozitat dhe kufizimet e parashikuara në ligj dhe/ose në Statut ose eventualisht në vendimin e emërimit të tij nga Asambleja e Përgjithshme.

Neni 8 – Gjuha

Ky Akt Themelimi është hartuar në 7 (shtatë) kopje origjinale në gjuhën shqipe.

* * * * *

NË DËSHMI TË SA MË SIPËR, Palët e paraqitura, deklaruan se ky Akt Themelimi është në përputhje të plotë me vullnetin e tyre, dhe e nënshkruan atë në praninë time, Noterit, në datën e sotme, me vullnetin e tyre të plotë e të lirë, dhe unë Noteri vërtetoj nënshkrimet e tyre sipas ligjit.

ORTAKËT

E SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR

“ARMEN SOLAR SH.P.K.”

Blessed Investment Sh.p.k.
Përfaqësuar nga
Znj. Ana Lleshi
Administrator

Matrix Konstruksion Sh.p.k.
Përfaqësuar nga
Znj. Ida Mezini
Administrator

Ana Lleshi



Znj. Borana Gusho

Znj. Vasillo Kuro

Borana Gusho
Gusho

Vasillo Kuro



NOTERI

[Large handwritten signature]



A2023051400317642733

Shtojca A

STATUTI
I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
“ARMEN SOLAR SH.P.K.”

Sot më datë ___/___/2023, në bazë të Ligjit Nr. 9901, datë 14/04/2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar (“Ligji Tregtar”) dhe Ligjit Nr. 131/2015 “Për Qendrën Kombëtare të Biznesit” i ndryshuar, palët e mëposhtme:

1. **BLESSED INVESTMENT SH.P.K.**, një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar e themeluar në përputhje me ligjet e Republikës së Shqipërisë, e regjistruar në Regjistrin Tregtar shqiptar mbajtur nga Qendra Kombëtare e Biznesit me NUIS L71423028S, me seli në adresën: Njësia Bashkiake Nr. 2, Rruga “Themistokli Gërmenji”, përballë RTSH, K i I, Tiranë, Shqipëri, e përfaqësuar nga Administratori i saj Znj. Ana Lleshi, shtetase shqiptare, e bija e Bashkim-it, lindur më 07/05/1981, në Tiranë dhe banuese në Tiranë, mbajtëse e letërnjoftimit ID me Nr. 036384557 dhe Nr.personal I15507055G, madhore dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar;
2. **MATRIX KONSTRUKSION SH.P.K.**, një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar e themeluar në përputhje me ligjet e Republikës së Shqipërisë, e regjistruar në Regjistrin Tregtar shqiptar mbajtur nga Qendra Kombëtare e Biznesit me NUIS J91306009Q, me seli në adresën: Njësia Bashkiake Nr.7, Rruga “Nikolla Jorga”, Godina Nr. 18/2, Tiranë, Shqipëri, e përfaqësuar nga Administratori i saj Znj. Ida Mezini, shtetase shqiptare, e bija e Shefit-it, lindur më 24/07/1971, në Berat, banuese në Tiranë, mbajtëse e letërnjoftimit ID me Nr. 036980443 dhe Nr. personal H15724048V, madhore dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar;
3. **Znj. Borana Gusho**, shtetase shqiptare, atësia Frederik, lindur më 10/06/1984, në Tiranë, banuese në Tiranë, në adresën: Rruga “Prokop Myzeqari”, Hyrja 1, Apartamenti 4, mbajtëse e letërnjoftimit ID me Nr. 038142754 dhe Nr. personal I45610083J, madhore dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar;
4. **Znj. Vasillo Kuro**, shtetase shqiptare, atësia Jorgji, lindur më 10/11/1962, në Ksamil, banuese në Tiranë, në adresën: Rruga “Liman Kaba”, Nd. 38, H. 8, Ap. 4, Njësia Administrative Nr. 5, 1019, mbajtëse e letërnjoftimit ID me Nr. 036473948 dhe Nr.personal G26110018G, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar;

me cilësinë e Ortakëve kanë vendosur të nënshkruajnë Statutin e mëposhtëm të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar, aktiviteti i së cilës rregullohet nga legjislacioni shqiptar në fuqi dhe nga ky Statut.

KAPITULLI I
FORMA, EMËRTIMI, OBJEKTI, SELIA, KOHËZGJATJA

Neni 1 – Forma

- 1.1 Shoqëria “Armen Solar” Sh.p.k. (në vijim referuar si “Shoqëria”) krijohet në formën e një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar, dhe veprimtaria e saj rregullohet me anë të këtij Statuti dhe Aktit të Themelimit.
- 1.2 Shoqëria vepron sipas legjislacionit shqiptar në fuqi.
- 1.3 Akti i Themelimit dhe Statuti janë në përputhje me legjislacionin shqiptar që ka karakter të detyrueshëm, ndërsa çështjet që nuk janë shprehimisht të parashikuara në to, plotësohen nga legjislacioni shqiptar.



A2023051400217641733

Neni 2 – Emërtimi

- 2.1 Emërtimi i Shoqërisë është **Armen Solar Sh.p.k.**

Neni 3 – Objekti i Shoqërisë

- 3.1 Shoqëria ka për objekt kryerjen e aktiviteteve tregtare në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi.
- 3.2 Në mënyrë më specifike, Shoqëria do të mund të kryejë aktivitetin e veprimtarive tregtare në fushën e zhvillimit dhe prodhimit të energjisë elektrike nga burimet e rinovueshme, studim, projektim, zbatim, ndërtim, instalim, komisionim, financim, operim, prodhim dhe tregtim i energjisë elektrike nga burime të rinovueshme, si parqet e erës (eolike), ujore, sistemet fotovoltaike, termocentralet, biomasa, etj. dhe infrastrukturat shërbyese.
- 3.3 Përveç sa më sipër, Shoqëria mund të kryejë çdo aktivitet që lidhet direkt ose indirekt, që është rezultat ose lidhet me objektivin e mësipërm, siç mund të konsiderohet i nevojshëm apo i dobishëm apo ndihmës në përmbushjen e qëllimeve të mësipërme.
- 3.4 Gjithashtu, për arritjen e qëllimeve të mësipërme, Shoqëria mund të kryejë çdo aktivitet të ligjshëm tregëtar që lidhet me çfarëdolloj pasurie të luajtshme dhe/ose të paluajtshme, duke përfshirë por pa u kufizuar vetëm në blerjen, shitjen, transferimin, ndërtimin, nën-kontraktimin, disponimin, posedimin, menaxhimin, marrjen apo dhënien me qira, *leasing* e pasurive të luajtshme dhe/ose të paluajtshme, dhënien e fitimit e çdo të drejte apo privilegji në lidhje me këto pasuri, dhe çdo aktivitet tjetër tregëtar, financiar, qeraje ose hipoteke, që mund të konsiderohet i vlefshëm ose i nevojshëm në mënyrë që të ushtrohet objekti i Shoqërisë.
- 3.5 Së fundi, Shoqëria mund të kryejë çdo operacion tregëtar që lidhet me burimet e rinovueshme të energjisë elektrike, operacione financiare dhe kredimarrje, të japë garanci të tretëve, si edhe të ketë pjesëmarrje në shoqëri, ente, konsorciume, të themeluara apo në themelim e sipër, që kanë objekt të njëjtë ose të ngjashëm me të vetin apo gjithësesi funksional për arritjen e qëllimeve të Shoqërisë. Më në përgjithësi, Shoqëria mund të kryejë çdo aktivitet tjetër të nevojshëm apo të dobishëm të lejuar nga ligji për realizimin e qëllimeve të Shoqërisë.

Neni 4 – Selia

- 4.1 Selia e Shoqërisë është në adresën: Njësia Bashkiake Nr. 2, Rruga “Themistokli Gërmenji”, Ndërtesa 1, Tiranë, Shqipëri.
- 4.2 Transferimi i selisë së Shoqërisë në një vend tjetër bëhet me vendimin e Asamblesë së Ortakëve.
- 4.3 Shoqëria mund të ketë zyra, degë, zyra përfaqësimi dhe agjenci si në adresa të tjera në Shqipëri ashtu edhe jashtë saj. Asambleja e Ortakëve mund të vendosë të çelë, transferojë dhe/apo mbyllë, si në Shqipëri ashtu edhe jashtë saj, seli sekondare, filiale, degë, agjenci, zyra përfaqësimi si dhe çfarëdo entiteti tjetër të çdo lloji.

Neni 5 – Kohëzgjatja e veprimtarisë

- 5.1 Kohëzgjatja e veprimtarisë së Shoqërisë do të jetë me një afat të pacaktuar.
- 5.2 Shoqëria mund të prishet përpara këtij afati me vendim të Asamblesë së Ortakëve.



A2023051400217642733

KAPITULLI II KAPITALI THEMELTAR, KONTRIBUTET, NNDARJA DHE TRANSFERIMI I KUOTAVE

Neni 6 – Kapitali themeltar

- 6.1 Kapitali themeltar i Shoqërisë është 100,000 Lekë (njëqind mijë lekë).
- 6.2 Kapitali themeltar i Shoqërisë përbëhet nga 4 (katër) kuota të nënshkruara.

Neni 7 - Kontributet

- 7.1 Kontributi në kapitalin e Shoqërisë është ofruar si më poshtë:
- **Ortaku Blessed Investment Sh.p.k.**, ka ofruar një kontribut në para të barabartë me 30,000 Lekë (tridhjetë mijë lekë);
 - **Ortaku Matrix Konstruksion Sh.p.k.**, ka ofruar një kontribut në para të barabartë me 30,000 Lekë (tridhjetë mijë lekë);
 - **Ortaku Borana Gusho**, ka ofruar një kontribut në para të barabartë me 20,000 Lekë (njëzetë mijë lekë);
 - **Ortaku Vasillo Kuro**, ka ofruar një kontribut në para të barabartë me 20,000 Lekë (njëzetë mijë lekë);
- 7.2 Sipas kontributeve të mësipërme:
- **Ortakut Blessed Investment Sh.p.k.**, i përket 1 (një) kuota, që i korrespondon 30% (tridhjetë përqind) të kapitalit të Shoqërisë;
 - **Ortakut Matrix Konstruksion Sh.p.k.**, i përket 1 (një) kuota, që i korrespondon 30% (tridhjetë përqind) të kapitalit të Shoqërisë;
 - **Ortakut Borana Gusho**, i përket 1 (një) kuota, që i korrespondon 20% (njëzetë përqind) të kapitalit të Shoqërisë;
 - **Ortakut Vasillo Kuro**, i përket 1 (një) kuota, që i korrespondon 20% (njëzetë përqind) të kapitalit të Shoqërisë;

Neni 8 – Rritja e kapitalit themeltar

- 8.1 Kapitali themeltar mund të rritet pa kufi në çdo moment, një ose disa herë, me vendim të Asamblesë së Ortakëve.
- 8.2 Në rast rritjeje të kapitalit, të gjithë ortakët kanë të drejtën të nënshkruajnë rritjen në raport kuotat e zotëruara. Në rast se disa nga ortakët nuk e ushtrojnë këtë të drejtë, pjesët e tyre mund të nënshkruhen nga ortakët e tjerë proporcionalisht me kuotat e zotëruara prej tyre.

Neni 9 – Zvogëlimi i kapitalit themeltar

- 9.1 Shoqëria mund të zvogëlojë kapitalin themeltar me vendimin e Asamblesë së Ortakëve. Në çdo rast kapitali themeltar nuk mund të zvogëlohet nën kufijtë e parashikuar nga ligji.
- 9.2 Zvogëlimi i kapitalit përballohet nga secili prej ortakëve në të njëjtën masë me kuotat e zotëruara prej tyre.



A2023051400317642723

Neni 10 – Transferimi i kapitalit / kuotave

- 10.1 Pjesët e kapitalit themeltar / kuotat e Shoqërisë janë lirisht të transferueshme ndërmjet ortakëve.
- 10.2 Në rast transferimi në çdo lloj forme, si me shpërblim ashtu edhe pa shpërblim në kuptimin më të gjerë të fjalës, duke përfshirë këtu edhe dhurimin në favor të subjekteve të tjerë të ndryshëm nga ortakët, kuotat duhet më parë t'i ofrohen në parablerje ortakëve të tjerë.
- 10.3 Në një rast të tillë ortaku që ka si qëllim të transferojë pronësinë e kuotës së tij ose një pjese të saj në favor të të tretëve, duhet të njoftoj me shkrim ortakët e tjerë, me letër rekomande me kthim përgjigje, mbi synimin për transferimin e pronësisë së kuotës ose të një pjese të saj, duke përcaktuar çmimin e shitblerjes, kushtet, modalitetet, emrin dhe të dhënat identifikuese të përfituesit, dhe afatet e transferimit. E drejta e parablerjes duhet t'i referohet të gjitha kuotave të ofruar për shitje.
- 10.4 Ortakët e tjerë do të kenë në dispozicion 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga marrja e njoftimit (letrës rekomande), për t'i komunikuar ortakut që transferon kuotën, interesin e tyre për të ushtruar apo jo të drejtën e parablerjes mbi kuotën e ofruar kundrejt të njëjtit çmim të përcaktuar në njoftimin e mësipërm.
- 10.5 Në rast se ortakët e tjerë nuk përgjigjen në afatin e caktuar në nenin 10.4 më sipër, prezumohet se kanë hequr dorë nga ushtrimi i së drejtës së parablerjes.
- 10.6 E drejta e parablerjes nuk mund të ushtrohet vetëm për një pjesë të kuotave të ofruara për transferim.
- 10.7 Nëse e drejta e parablerjes ushtrohet nga më shumë se një ortak, atëherë kuotat e ofruara për shitje do të blihen nga këta ortakë në përpjestim të drejtë me pjesëmarrjen e tyre në Shoqëri.
- 10.8 Në rast se nuk ushtrohet e drejta e parablerjes siç parashikohet nga nenet 10.1 deri në 10.7 të këtij Statuti sipas vendimmarrjes së ortakëve, kuotat mund t'i transferohen lirisht vetëm të tretëve të përcaktuar në njoftimin e parashikuar në nenin 10.3 më sipër kundrejt çmimit të parashikuar aty.
- 10.9 E drejta e parablerjes nuk mund të ushtrohet në rastin kur subjekti të cilit do ti transferohen kuotat është një shoqëri drejtpërsëdrejti ose tërthorazi e kontrolluar nga ortaku që ka si qëllim të transferojë kuotat në fjalë. Në këtë rast ortaku që ka si qëllim të transferojë kuotat duhet të njoftojë me shkrim ortakët e tjerë duke bashkangjitur dokumentacionin që provon lidhjen e mësipërme. Për më shumë qartësi, në kuptimin e kësaj dispozite statutore, "kontroll" do të thotë zotërimi direkt ose indirekt i shumicës absolute të totalit të votave (pra 50%+1). Për më shumë qartësi, sa më sipër, nuk përjashton ushtrimin e të drejtës së parablerjes në rastin e transferimit indirekt në favor të të tretëve të pronësisë së kuotave të Shoqërisë, nëpërmjet transferimit të pronësisë së kuotave të shoqërisë së posaçme të krijuar *ad hoc* nga ortaku me qëllim ekskluziv zotërimin e kuotave të Shoqërisë (*Special Purpose Vehicle*).
- 10.10 Me përjashtim të rastit kur të gjithë ortakët e Shoqërisë me unanimitet vendosin ndryshe, pronësia e kuotave të Shoqërisë nuk mund t'i transferohet të tretëve, nëse kundërvlera e ofruar nga i treti për përfitimin e pronësisë së kuotave të Shoqërisë është në natyrë.
- 10.11 Në rast të transferimit të kuotave për shkak trashëgimie *mortis causa* ortakët e tjerë kanë të drejtë të shprehin pëlqimin e tyre për ortakët e rinj. Në rast se nuk jepet



A2013051400217642723

pëlqimi, kuotat mund t'u transferohen të tretëve plotësisht apo pjesërisht, me vendimin pozitiv të Asamblesë së Ortakëve.

- 10.12 Transferimi i kuotave në favor të të tretëve është i pavlefshëm dhe nuk ka efekt nëse nuk kryhet sipas parashikimeve të këtij neni.
- 10.13 Me përjashtim të rastit kur të gjithë ortakët e Shoqërisë me unanimitet vendosin ndryshe, asnjë prej ortakëve nuk mund të vendosë peng, barrë siguroese ose çfarëdolloj barre ose kufizim tjetër mbi kuotat përkatëse, me përjashtim të rastit kur kufizimet/barrat e mësipërme mbi kuotat jepen nga ortakë në interes të Shoqërisë për të mundësuar përfitimin e një financimi prej saj nga institucionet financiare.

KAPITULLI III ASAMBLEJA, ADMINISTRATORËT DHE EKSPERTI KONTABËL

Neni 11 – Asambleja e Ortakëve dhe kompetencat e saj

- 11.1 Organi vendim-marrës i Shoqërisë është Asambleja e Ortakëve.
- 11.2 Asambleja e Ortakëve është organi i vetëm vendim-marrës i Shoqërisë që miraton çdo ndryshim të statutit sipas modaliteteve të përcaktuara në ligj.
- 11.3 Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve është përgjegjëse, ndër të tjera, por jo vetëm, për marrjen e vendimeve për Shoqërinë për çështjet e mëposhtme:
- (a) përcaktimin e politikave tregtare të Shoqërisë;
 - (b) ndryshimet e statutit;
 - (c) emërimin e shkarkimin e administratorëve;
 - (d) emërimin e shkarkimin e likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
 - (e) përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat "c" dhe "d" të kësaj pike;
 - (f) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
 - (g) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
 - (h) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
 - (i) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
 - (j) përfaqësimin e Shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
 - (k) riorganizimin dhe prishjen e Shoqërisë;
 - (l) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
 - (m) çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.
- 11.4 Asambleja e Përgjithshme është kompetente, ndër të tjera, për (i) miratimin e planit të biznesit dhe buxheti vjetor, si dhe modifikimet e tyre; (ii) pjesëmarrjen në themelimin e shoqërive të tjera, konsorciume, joint venture ose marrëveshje të tjera me natyrë të ngjashme; (iii) shitja ose blerja e *business unit* apo pjesëmarrjeve në subjekte të tjera; (iv) lidhjen e kontratave me palë të lidhura të përcaktuara në nenin 13 të Ligjit Tregtar; (v) kontratat që kanë si objekt transferimin e pronësisë, vendosjen e të drejtave reale kufizuese, të çfarëdolloj forme ose të drejta përdorimi mbi pasuritë e luajtshme dhe/ose të paluajtshme që janë *core business* i Shoqërisë; (vi) marrjen e çdo huaje, në çfarëdolloj forme, me një vlerë më të lartë se 10,000 Euro (dhjetë mijë euro), si dhe marrjen e çdo huaje, pavarësisht nga vlera e saj, nëse shuma e të gjitha huave të marra nga Shoqëria gjatë të njëjtës periudhë ushtrimore tejkalon vlerën totale prej 10,000 Euro (dhjetë mijë euro), si dhe dhënia e garancive përkatëse; (vii) dhënien



A2023051400217642723

e financimeve apo garancive në favor të të tretëve, në çfarëdo lloji forme dhe vlere; (viii) punësimin apo angazhimin e punonjësve apo konsulentëve pagesa mujore e të cilëve është më e lartë se 4,000 Euro (katër mijë euro), si dhe modifikimi apo zgjidhja e kontratave përkatëse; (ix) çfarëdo lloji veprimi/marrëdhënie juridike e cila nuk është parashikuar në buxhetin vjetor të miratuar paraprakisht nga Asambleja e Përgjithshme; (x) lidhjen e çdo kontrate me një vlerë të përgjithshme vjetore më të lartë se 10,000 Euro (dhjetë mijë euro), si dhe modifikimi ose zgjidhja e saj, si dhe çfarëdo lloji kontrate tjetër, pavarësisht nga vlera e saj, nëse shuma totale e vlerës së të gjitha kontratave të të njëjtit lloji shërbimi ose produkti të nënshkruara gjatë të njëjtit periudhë ushtrimore tejkalon vlerën totale prej 10,000 Euro (dhjetë mijë euro); (xi) miratimin e transaksioneve/veprimeve bankare dhe/ose çdo veprim tjetër tregtar që do të tejkalojë vlerën prej 10,000 Euro (dhjetë mijë euro); (xii) kontratat e sponsorizimeve aktive si dhe dhurimet; (xiii) blerjen ose shitjen e pronave të paluajtshme ose vendosja e garancive mbi to.

Neni 12 – E drejta e pjesëmarrjes dhe e votës

- 12.1 Çdo ortak ka të drejtë të marrë pjesë në asamblenë e përgjithshme, të shpreh mendimin e tij dhe ka të drejta vote në përpjesëtim me vlerën nominale të kuotës në pronësinë e tij. Ortaku nuk mund të votojë në një mënyrë me një pjesë të kuotës dhe në një mënyrë tjetër me pjesën e mbetur të saj.
- 12.2 Çdo ortak ka të drejtë të përfaqësohet në asamblenë e përgjithshme nga një person tjetër jo-ortak, i pajisur me autorizim/prokurë me shkrim, me anën e së cilës mund të japë votën e tij.
- 12.3 Ortaku nuk mund të lëshojë autorizim/prokurë për të votuar për një pjesë të kapitalit që zotëron, në qoftë se voton personalisht për pjesën e mbetur.
- 12.4 Administratori i shoqërisë nuk mund të veprojë si përfaqësues i ortakëve në asamblenë e përgjithshme.
- 12.5 Autorizimi/Prokura mund të jepet vetëm për një mbledhje të asamblesë së përgjithshme, e cila përfshin edhe mbledhjet vijuese me të njëjtin rend dite.

Neni 13 – Thirrja e Asamblesë së Ortakëve, Kuorumi dhe Vendimet

- 13.1 Asambleja e Ortakëve thirret të paktën një herë në vit, brenda 6 (gjashtë) muajve nga mbyllja e vitit financiar për miratimin e bilancit vjetor të vitit të mëparshëm fiskal, të raportit të Administratorit dhe ekspertit kontabël.
- 13.2 Asambleja e përgjithshme thirret nëpërmjet një njoftimi me shkresë me letër rekomandë me kthim përgjigje që duhet t'u dërgohet ortakëve në adresën që kanë deklaruar ose me njoftim nëpërmjet postës elektronike, të paktën 7 (shtatë) ditë përpara datës së parashikuar për mbledhjen e Asamblesë. Njoftimi me shkresë apo me mesazh elektronik duhet të përmbajë vendin, datën, orën e mbledhjes dhe rendin e ditës dhe eventualisht edhe datën, vendin dhe orën e mbledhjes vijuese, nëse e para nuk arrin të mblihet.
- 13.3 Asambleja e Përgjithshme mund të thirret në çdo moment prej Administratorit, në rastin kur është e nevojshme për interesat e Shoqërisë apo kur kërkohet nga ligji, sikurse edhe nga një apo më shumë ortakë të cilët përfaqësojnë të paktën 5% (pesë përqind) të kapitalit të Shoqërisë përmes një kërkesë të shkruar drejtuar Administratorit/ve. Nëse Administratori refuzon të thërrasë Asamblenë brenda 3 (tre) ditëve pune nga kërkesa e ortakëve, këta ortakë kanë të drejtë të thërrasin vetë Asamblenë në përputhje me nenin 82, paragrafi i dytë, 83 (paragrafi i parë) dhe 84



A2023051400217642733

(paragrafi i parë) të Ligjit Tregtar.

- 13.4 Asambleja e Përgjithshme mund të thirret edhe në një vend të ndryshëm nga selia e Shoqërisë në Shqipëri apo jashtë saj.
- 13.5 Në rast se Asambleja e Përgjithshme nuk mund të mbledhet me thirjen e parë për shkak të mungesës së kuorumit të parashikuar në nenin 13.12 të këtij Statuti, Asambleja e Përgjithshme do të thirret përsëri brenda 30 (tridhjetë) ditësh, me të njëjtin rend dite.
- 13.6 Asambleja e Përgjithshme mund të zhvillohet edhe nëpërmjet telekonferencës dhe videokonferencës, me kusht që të gjithë pjesëmarrësit të mund të identifikohen, t'u lejohej atyre të ndjekin diskutimin, të ndërhyjnë në momentin e trajtimit të çështjeve në rend të ditës, të japin mendimet e tyre në kohë reale lidhur me trajtimin e argumenteve dhe të votojnë në të njëjtën kohë mbi pikat e rendit të ditës. Nëse përmbushen këto kushte, Asambleja e Përgjithshme konsiderohet e zhvilluar në vendin ku ndodhet Kryetari i mbledhjes dhe ku gjithashtu duhet të ndodhet edhe Sekretari.
- 13.7 Kur Asambleja e Përgjithshme nuk është thirrur duke respektuar formalitetet e njoftimit sipas pikës 13.2 të këtij neni, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse i gjithë kapitali i Shoqërisë të jetë i pranishëm, qoftë edhe nëpërmjet autorizimit dhe të gjithë ortakët janë dakord, për të marrë vendime, pavarësisht parregullsisë.
- 13.8 Asambleja e Përgjithshme kryesohet nga një Kryetar i zgjedhur nga ortakët e pranishëm apo të përfaqësuar në Asamble. Për pasqyrimin e vendimit Asambleja zgjedh një Sekretar, i cili mund edhe të mos jetë ortak.
- 13.9 Kryetari i Asamblesë së Përgjithshme ka të drejtë të plotë të verifikojë prokurat dhe/ose autorizimet dhe vlefshmërinë e tyre, të drejtën e ortakëve dhe përfaqësuesve të tyre për të marrë pjesë në Asamblesë të Përgjithshme dhe të vendosë nëse kjo e fundit është mbledhur në mënyrë të rregullt dhe nëse kuorumi i nevojshëm për të marrë vendime është arritur vlefshmërisht. Kryetari ka edhe të drejtën të kryesojë bisedimet dhe të marrë vendime mbi rregullat dhe procedurat lidhur me votën.
- 13.10 Vendimet, procesverbalet dhe lista e pjesëmarrësve të Asamblesë së Përgjithshme duhet të përgatiten menjëherë pas mbajtjes së saj dhe duhet të nënshkruhen prej Kryetarit dhe Sekretarit të Asamblesë së Përgjithshme, dhe të regjistrohen në librin e vendimeve të Shoqërisë.
- 13.11 Pavarësisht nga sa më sipër, një vendim i Asamblesë së Përgjithshme mund të merret vlefshmërisht edhe me anë të një vendimi qarkullues me shkrim me kusht që ky vendim qarkullues të nënshkruhet nga të gjithë ortakët. Propozimi i vendimit me të gjithë dokumentacionin e nevojshëm sqarues bashkëngjitur duhet t'i dërgohet me rradhë të gjithë ortakëve, me çdo mjet të përshtatshëm që provon marrjen e tij nga këta të fundit. Nga propozimi duhet të rezultojë në mënyrë të qartë çështja në rend të ditës dhe gjithë sa është e nevojshme për të siguruar informacionin e duhur mbi çështjen në fjalë, si dhe teksti përfundimtar i vendimit që duhet nënshkruar. Krahas nënshkrimit të vendimit nga secili prej ortakëve, duhet shprehur në vendim edhe mënyra sesi ka votuar secili prej tyre. Kuorumi i vendimarrjes është ai që është i parashikuar në nenin 13.13 të Statutit. Do të konsiderohet datë e vendimarrjes data në të cilin është materializuar nënshkrimi i ortakut të fundit. Këto vendime dhe i gjithë dokumentacioni shoqëruar që shpreh vullnetin e ortakëve duhet të regjistrohen në librin e vendimeve të Shoqërisë.

10



A2023651400217642723

- 13.12 Vendimet e Asamblesë së Përgjithshme, për të cilat kërkohet një shumicë e thjeshtë, janë të vlefshme nëse janë të pranishëm ortakët me të drejtë vote që zotërojnë më shumë se 30% (tridhjetë përqind) të kapitalit themeltar. Vendimet e Asamblesë së Përgjithshme për çështje të cilat kërkojnë një shumicë të kualifikuar sipas nenit 87 të Ligjit Tregtar ose në rastet e parashikuara në paragrafet (c) (emërimi i administratorit), (d), (e) të nenit 11.3 (me përjashtim të shkarkimit të administratorit) dhe në nenin 11.4 të statutit, janë të vlefshme vetëm nëse ortakët që zotërojnë të paktën 51% (pesëdhjetë e një përqind) të kapitalit themeltar, janë të pranishëm personalisht, votojnë me shpresë, apo mjete elektronike, sipas parashikimeve të pikës 3 të nenit 88 të Ligjit Tregtar.
- 13.13 Asambleja e Përgjithshme vendos me votën pro të $\frac{3}{4}$ (tre të katërtat) e ortakëve të pranishëm që zotërojnë të paktën 51% (pesëdhjetë e një përqind) të kapitalit themeltar, për ndryshimet e statutit, zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit të regjistruar, transferimin e kuotave, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e Shoqërisë, si dhe për çështjet e përshkruara në paragrafet (c), (ç), (d) të nenit 11.3 dhe nenin 11.4 të statutit, dhe çdo çështje tjetër për të cilin ligji kërkon një shumicë të kualifikuar.
- Asambleja e Përgjithshme vendos me shumicë të thjeshtë votash të ortakëve që zotërojnë më shumë se 30% (tridhjetë përqind) të kapitalit të Shoqërisë, për çështje të tjera për të cilat statuti ose ligji nuk parashikon një shumicë të ndryshme të cilësuar.

Neni 14 – Administrimi

- 14.1 Shoqëria administrohet nga të paktën 1 (një) Administrator i cili do të qëndrojë në detyrë deri në shkarkim apo dorëheqje ose për një periudhë prej 5 (pesë) vitesh.
- 14.2 Përfaqësimi ligjor i Shoqërisë i besohet Administratorit. Administratori mund të ushtroj të gjitha fuqitë konform me sa parashikohet në nenin 95 të Ligjit Tregtar.
- 14.3 Administratori mund të emërojë përfaqësues të posaçëm për veprime apo kategori të caktuara veprimesh.
- 14.4 Administrator i Shoqërisë emërohet:
Z. Altin Mihali, shtetas shqiptar, atësia Argjir, lindur më 27/01/1972, në Kuçovë, banues në Tiranë, në adresën: Rruga “Tom Plezha”, Pallati “Fildish”, Hyrja 3, Ap. 9, mbajtës i pasaportës me Nr. BF1395624 dhe Nr. personal H201270451, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar.
- 14.5 Administratori mund të shkarkohet me vendim të ortakëve në çdo moment.
- 14.6 Administratori është personalisht përgjegjës përpara Shoqërisë dhe/ose palëve të treta për dëme të shkaktuara nga shkelja e dispozitave të këtij Statuti ose të ligjit.

Neni 15 - Kompetencat e Administratorit

- 15.1 Administratori ka të drejtë e detyrohet të:
- kryejë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të Shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare të vendosura nga Asambleja e Përgjithshme në përputhje me dispozitat dhe kufizimet e parashikuara në ligj dhe/ose në këtë statut ose eventualisht në vendimin e emërimit të tij nga Asambleja e Përgjithshme;
 - përfaqësojë Shoqërinë në përputhje me dispozitat dhe kufizimet e parashikuara në ligj dhe/ose në këtë statut ose eventualisht në vendimin e emërimit të tij nga Asambleja e Përgjithshme;
 - kujdeset për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël



A2023051400217642723

- të Shoqërisë;
- (d) përgatisë dhe nënshkruajë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqet këto dokumente përpara Asamblesë së Përgjithshme për miratim;
 - (e) krijojë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e Shoqërisë;
 - (f) kryejë regjistrimet dhe dërgojë të dhënat e detyrueshme të Shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Biznesit;
 - (g) raportojë përpara Asamblesë së Përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e Shoqërisë;
 - (h) kryejë detyra të tjera të përcaktuara në ligj dhe në statut.
- 15.2 Administratori është i detyruar të thërrasë Asamblenë e Përgjithshme, në rastet kur:
- (i) sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezulton ose ekziston rreziku që aktivet e Shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 muajve në vazhdim.
 - (ii) Shoqëria propozon të shesë apo të disponojë në mënyrë tjetër aktive, të cilat kanë një vlerë më të lartë se 5 për qind të aseteve të Shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.
 - (iii) Shoqëria, brenda 2 viteve të para pas regjistrimit të saj, propozon të blejë nga një ortak pasuri, që kanë vlerë më të lartë se 5 për qind të aseteve të Shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.
- 15.3 Përveç sa parashikohet në Ligjin Tregtar dhe në këtë Statut, në lidhje me kompetencat, Administratori do të nënshkruajë çdo kontratë me një vlerë të përgjithshme vjetore më të lartë se 10,000 Euro (dhjetë mijë euro), si dhe modifikimin ose zgjidhjen e saj, si dhe çfarëdolloj kontrate tjetër, pavarësisht nga vlera e saj, nëse shuma totale e vlerës së të gjitha kontratave të të njëjtit lloj shërbimi ose produkti të nënshkruara gjatë të njëjtes periudhë ushtrimore tejkalon vlerën totale prej 10,000 Euro (dhjetë mijë euro), si dhe do të kryejë transaksione bankare dhe/ose çdo veprim tjetër tregtar që do të tejkalojë vlerën prej 10,000 Euro (dhjetë mijë euro), pas miratimit nga Asambleja e Përgjithshme.
- 15.4 Nëse Asambleja e Përgjithshme emëron më shumë se një administrator, ata e administrojnë bashkërisht Shoqërinë.
- 15.5 Asambleja e Përgjithshme mund të shkarkojë administratorin në çdo kohë me shumicë të zakonshme. Paditë, që lidhen me shpërblimin e administratorit, në bazë të marrëdhënieve kontraktore me Shoqërinë, rregullohen sipas dispozitave ligjore në fuqi.

Neni 16 – Përgjegjësitë e Administratorit

- 16.1 Administratori është përgjegjës individualisht, ndaj Shoqërisë ose ndaj të tretëve, për shkelje të ligjeve, për shkelje të statutit, apo për faje të kryera gjatë administrimit të Shoqërisë.
- 16.2 Pasojat e marrëveshjeve të pamiratuara nga Asambleja e Përgjithshme që i sjellin dëm Shoqërisë, i ngarkohen administratorit dhe ortakut që ka bërë marrëveshjen, për të përballuar në mënyrë individuale ose solidarisht sipas rastit pasojat përkatëse.
- 16.3 Përveç sa është parashikuar në dispozitat e përgjithshme të detyrimit të besnikërisë, sipas neneve 14, 15, 17 e 18 të Ligjit Tregtar, Administratori detyrohet:
- (1) a) të kryejë detyrat e tij të përcaktuara në ligj dhe në statut në mirëbesim e në interesin më të mirë të Shoqërisë në tërësi, duke i kushtuar vëmendje të veçantë ndikimit të veprimtarisë së Shoqërisë në mjedis;



A202305140011-64773

- b) të ushtrojë kompetencat që i njihen në ligj dhe në statut vetëm për arritjen e qëllimeve të përcaktuara në këto dispozita;
- c) të vlerësojë me përgjegjësi çështjet, për të cilat merret vendim;
- d) të parandalojë dhe mënjanojë rastet e konfliktit, prezent apo të mundshëm, të interesave personalë me ata të Shoqërisë;
- e) të ushtrojë detyrat e tij me profesionalizmin dhe kujdesin e nevojshëm.
- (2) Administratori, gjatë kryerjes së detyrave të tij, përgjigjet ndaj Shoqërisë për çdo veprim ose mosveprim, që lidhet në mënyrë të arsyeshme me qëllimet e Shoqërisë, me përjashtim të rasteve kur, në bazë të hetimit dhe vlerësimit të informacioneve përkatëse, veprimi ose mosveprimi është kryer në mirëbesim. Sidoqoftë, mirëbesimi nuk përjashton përgjegjësinë e Administratorit në rast kur veprimi ose mosveprimi kryhet për shkak të neglizhencës së tij.
- (3) Nëse Administratori vepron në kundërshtim me detyrat dhe shkel standardet profesionale, sipas pikave 1 e 2 të këtij neni, është i detyruar t'i dëmshpërblejë Shoqërisë dëmet, që rrjedhin nga kryerja e shkeljes, si dhe t'i kalojë çdo fitim personal që ai apo personat e lidhur me të kanë realizuar nga këto veprime të parregullta. Administratori ka barrën e provës për të vërtetuar kryerjen e detyrave të tij në mënyrë të rregullt e sipas standardeve të kërkuara. Kur shkelja është kryer nga më shumë se një administrator, ata përgjigjen ndaj Shoqërisë në mënyrë solidare.
- (4) Në mënyrë të veçantë, por pa u kufizuar në to, Administratori është i detyruar t'i dëmshpërblejë Shoqërisë dëmet e shkaktuara, nëse, në kundërshtim me dispozitat e Ligjit Tregtar, kryen veprimet e mëposhtme:
- u kthen ortakëve kontributet;
 - u paguan ortakëve interesa apo dividendë;
 - u shpërndan aktivet Shoqërisë;
 - lejon që Shoqëria të vazhdojë veprimtarinë tregtare, kur, në bazë të gjendjes financiare, duhej të parashikohej që Shoqëria nuk do të kishte aftësi paguese për të shlyer detyrimet;
 - jep kredi.
- 16.4 Përveç padisë për shlyerjen e dëmit që i ngarkohet personalisht Administratorit, ortakët individualisht ose së bashku, kanë të drejtë të ngrenë padi penale kundër Administratorit.
- 16.5 Padiësit kanë të drejtë të ndjekin në rrugë ligjore shlyerjen e plotë të dëmit që i është shkaktuar Shoqërisë, përfshirë edhe dëmshpërblimin financiar, nëse është e nevojshme. Asnjë vendim i asamblesë nuk mund të ndalojë ngritjen e kërkesë padisë kundër administratorit për gabimet e kryera prej tij gjatë ushtrimit të detyrës.

Neni 17 – Eksperti kontabël i autorizuar

- 17.1 Në rast se kërkohet nga ligji apo vendoset nga Asambleja e Ortakëve, kontrolli i bilanceve dhe librave kontabël të Shoqërisë mund t'i besohet një ose disa ekspertëve kontabël të autorizuar.
- 17.2 Eksperti kontabël i autorizuar mund të shkarkohet sipas mënyrës së parashikuar nga legjisllacioni në fuqi.

KAPITULLI IV VITI FINANCIAR, BILANCI VJETOR, SHPËRNDARJA E FITIMEVE

Neni 18 - Viti financiar dhe bilanci vjetor

- 18.1 Viti financiar fillon më 1 janar dhe mbaron më 31 dhjetor të secilit vit.



A2023051400217642723

- 18.2 Viti i parë financiar fillon në datën e regjistrimit të Shoqërisë në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe përfundon më 31 dhjetor të të njëjtit vit.
- 18.3 Bilancet vjetore, inventari, raportet e Administratorit dhe ekspertit kontabël të autorizuar miratohen nga Asambleja me shumicën e kërkuar nga Ligji Tregtar.
- 18.4 Miratimi i dokumentave që lidhen me vitin financiar duhet të bëhet brenda 6 (gjashtë) muajve që nga fundi i vitit financiar.

Neni 19 – Fitimet

- 19.1 Fitimet që rezultojnë nga bilanci vjetor, u shpërndahen ortakëve në proporcion me pjesët e kapitalit themeltar të zotëruara.
- 19.2 Asambleja mund të vendosë edhe zbritje të veçanta në favor të rezervave të jashtëzakonshme ose për qëllime të tjera apo dhe shtyrjen e shpërndarjes së fitimeve, plotësisht ose pjesërisht, për vitet financiare të ardhshme.

KAPITULLI V SHPËRNDARJA DHE LIKUIDIMI I SHOQËRISË

Neni 20 – Prishja

- 20.1 Shoqëria priset me përfundimin e afatit të parashikuar nga Statuti, ose përpara përfundimit në rastet e parashikuara nga ligji, ose me anë të një vendimi të Asamblesë së Ortakëve, me shumicën e kërkuar për ndryshimet në statut.
- 20.2 Shoqëria nuk priset në rast të humbjes së zotësisë për të vepruar, vdekjes, likuidimit apo falimentimit të ortakëve.

Neni 21 – Likuidimi

- 21.1 Në rast prishje, Shoqëria duhet të likuidohet.
- 21.2 Për të administruar këtë procedurë, Asambleja emëron një ose më shumë likuidatorë, të cilët paraqesin raportet përfundimtare mbi gjendjen e aktivitetit dhe pasivitetit të Shoqërisë, mbi operacionet e likuidimit dhe mbi kohën e nevojshme për të përfunduar likuidimin.
- 21.3 Me përfundimin e procedurës së likuidimit, Asambleja do të vendosë mbi bilancin financiar përfundimtar, mbi punën e kryer nga likuiduesi dhe mbi përfundimin e procesit të likuidimit.
- 21.4 Pas pagimit të kreditorëve dhe mbledhjes së kredive, likuidatori do t'i shpërndajë të ardhurat përfundimtare të likuidimit ortakëve, në proporcion me pjesët e kapitalit të zotëruara prej tyre në kapitalin themeltar.

Neni 22 - Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

- 22.1 Të gjitha mosmarrëveshjet që mund të lindin në lidhje me interpretimin dhe/ose zbatimin e këtij Statuti dhe Aktit të Themelimit, si edhe ato që mund të lindin në përgjithësi midis ortakëve (përveç atyre personale apo jashtë Shoqërisë) ose midis një apo më shumë ortakëve dhe Shoqërisë, do të zgjidhen në mënyrë miqësore dhe do të diskutohen në mënyrë të drejtpërdrejtë ndërmjet palëve të interesuara.



A2023051400217643723

- 22.2 Në rast se nuk arrihet në një zgjidhje miqësore të mosmarrëveshjes, ato do t'i besohen Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Neni 23 – Gjuha

- 23.1 Ky Statut është hartuar në 7 (shtatë) kopje origjinale në gjuhën shqipe.

Neni 24 – Baza Ligjore

- 24.1 Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj në përputhje të plotë me këtë Statut dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar.
- 24.2 Për sa nuk parashikohet në këtë Statut, do të zbatohen dispozitat e legjislacionit shqiptar për shoqëritë tregtare, Kodit Civil dhe çfarëdo ligji tjetër specifik në Republikën e Shqipërisë.

ORTAKËT

E SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR


“ARMEN SOLAR SH.P.K.”

Blessed Investment Sh.p.k.
Përfaqësuar nga
Znj. Ana Lleshi
Administrator

Ana Lleshi

Matrix Konstruksion Sh.p.k.
Përfaqësuar nga
Znj. Ida Mezini
Administrator

Ida Mezini



Znj. Borana Gusho

Borana Gusho

B Gusho

Znj. Vasillo Kuro

Vasillo Kuro

V Kuro

Nr. Prot. Bl_2023_063

**VENDIM
I ORTAKUT TË VETËM TË SHOQËRISË
"BLESSED INVESTMENT" SH.P.K.**

Sot, më datë 05/06/2023, Ortaku i Vetëm i shoqërisë "BLESSED INVESTMENT" SH.P.K., me seli në adresën: Rruga "Themistokli Gërmenji", Nd. 1, Tiranë, Shqipëri, me numër unik të identifikimit NUIS L71423028S (në vijim quajtur "Shoqëria"), **Z. Besnik Leskaj**, shtetas shqiptar, lindur më 30/06/1976, në Tiranë, mbajtës i letërnjoftimit me Nr.personal H60630112W, merr në shqyrtim dhe vendos për çështjet si më poshtë vijon:

RENDI I DITËS

1. Miratimi i pjesëmarrjes së Shoqërisë në themelimin e një shoqërie tregtare me emërtimin tregtar "ARMEN SOLAR SH.P.K."
2. Autorizimi i Administratorit të Shoqërisë Znj. Ana Lleshi për të nënshkruar në emër dhe për llogari të Shoqërisë të gjitha aktet e nevojshme për themelimin e shoqërisë tregtare "ARMEN SOLAR SH.P.K."

Në përputhje me Statutin e Shoqërisë dhe legjislacionin shqiptar të zbatuar në Republikën e Shqipërisë, në lidhje me rendin e ditës, Ortaku i Vetëm i Shoqërisë me vullnetin e tij të lirë dhe të plotë,

VENDOSI:

1. Të miratojë pjesëmarrjen e Shoqërisë në themelimin e një shoqërie tregtare me emërtimin tregtar "ARMEN SOLAR SH.P.K.", me ortakë themelues:
 - (i) shoqërinë Blessed Investment Sh.p.k. e cila do të zotërojë 1 (një) kuotë të barabartë me 30% të kapitalit të shoqërisë së re dhe do të shlyhet nëpërmjet kontributit para;
 - (ii) shoqërinë Matrix Konstruksion Sh.p.k. e cila do të zotërojë 1 (një) kuotë të barabartë me 30% të kapitalit të shoqërisë së re dhe do të shlyhet nëpërmjet kontributit para;
 - (iii) Znj. Borana Gusho e cila do të zotërojë 1 (një) kuotë të barabartë me 20% të kapitalit të shoqërisë së re dhe do të shlyhet nëpërmjet kontributit para, dhe
 - (iv) Znj. Vasillo Kuro e cila do të zotërojë 1 (një) kuotë të barabartë me 20% të kapitalit të shoqërisë së re dhe do të shlyhet nëpërmjet kontributit para.



Shoqëria tregtare "ARMEN SOLAR SH.P.K." do të ketë një kapital themeltar të barabartë me 100,000 Lekë (njëqind mijë lekë).

Shoqëria Blessed Investment Sh.p.k. do të zotërojë një kuotë me vlerë të përgjithshme 30,000 Lekë (tridhjetë mijë lekë) që përbën 30% të kapitalit themeltar të shoqërisë "ARMEN SOLAR SH.P.K.", të cilën do ta shlyejë në para.

Selia e shoqërisë së re "ARMEN SOLAR SH.P.K." do të jetë: Njësia Bashkiake Nr. 2, Rruga "Themistokli Gërmenji", Ndërtesa 1, Tiranë, Shqipëri.

Objekti i aktivitetit të shoqërisë së re "ARMEN SOLAR SH.P.K." do të jetë: "Veprimtari tregtare në fushën e zhvillimit dhe prodhimit të energjisë elektrike nga burimet e rinovueshme, studim, projektim, zbatim, ndërtim, instalim, komisionim, financim, operim, prodhim dhe tregtim i energjisë elektrike nga burime të rinovueshme, si parqet e erës (eolike), ujore, sistemet fotovoltaike, termocentralet, biomasa, etj. dhe infrastrukturat shërbyese. Shoqëria e re ARMEN SOLAR Sh.p.k. mund të kryejë çdo aktivitet të ligjshëm tregëtar që lidhet me çfarëdolloj pasurie të luajtshme dhe/ose të paluajtshme, duke përfshirë por pa u kufizuar vetëm në blerjen, shitjen, transferimin, ndërtimin, nën-kontraktimin, disponimin, posedimin, menaxhimin, marrjen apo dhënien me qira, leasing e pasurive të luajtshme dhe/ose të paluajtshme, dhënien e fitimit e çdo të drejte apo privilegji në lidhje me këto pasuri, dhe çdo aktivitet tjetër tregtar, financiar, qeraje ose hipoteke, që mund të konsiderohet i vlefshëm ose i nevojshëm në mënyrë që të ushtrohet objekti i shoqërisë."


Administrator i shoqërisë tregtare "ARMEN SOLAR SH.P.K." do të jetë Z. Altin Mihali.

2. Të autorizojë Administratorin e Shoqërisë Znj. Ana Lleshi të përfaqësojë Shoqërinë në themelimin e shoqërisë tregtare "ARMEN SOLAR SH.P.K." duke nënshkruar në emër dhe për llogari të Shoqërisë të gjitha aktet e nevojshme dhe/ose të dobishme për themelimin e shoqërisë tregtare "ARMEN SOLAR SH.P.K."

Ortaku i Vetëm merr këtë vendim, duke mos patur çështje të tjera për shqyrtim në rendin e ditës.

BLESSED INVESTMENT SH.P.K.
Z. Besnik LESKAJ
Ortak i Vetëm

Besnik Leskaj





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E FINANCAYE DHE EKONOMISË
QENDRA KOMBËTARE E BIZNESIT

EKSTRAKT I REGJISTRIT TREGTAR PËR TË DHËNAT E SUBJEKTIT "SHOQËRI ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR"

GJENDJA E REGJISTRIMIT

1. Numri unik i identifikimit te subjektit (NUIS)	L71423028S	
2. Data e Regjistrimit	23/02/2017	
3. Emri i Subjektit	BLESSED INVESTMENT	
4. Forma ligjore	SHPK	
5. Data e themelimit	17/02/2017	
6. Kohëzgjatja	Nga: 17/02/2017	
7. Zyra qendrore e shoqërisë në Shqipëri	Tirane Tirane TIRANE Rruga Themistokli Gërmenji, Nd.1	
8. Kapitali	7.000.100,00	
8.1 Numri i përgjithshëm i kuotave	1,00	
9. Objekti i aktivitetit	Zhvillimi i pasurive te paluajtshme; Kryerja e operacioneve ekonomike, juridike e financiare si dhe e cdo biznesi qe lidhen drejteperdrejte ose terthorazi me realizimin e objektit te veprimtarise se shoqerise, brenda kuadrit te dispozitave ligjore. Kryerja e cdo operacioni tregtar, financiar dhe kreditimi, blerje, shitje ose marrje me qera te objekteve te ndryshme te luajtshme e te paluajtshme. Marrja pjese ne shoqeri e ne konsorciume te themeluara apo ne themelim e siper, qe kane objekt te njejte ose te ngjashem me te vetin apo gjithsesi funksional per arritjen e qellimeve te shoqerise. Studim, projektim, zbatim, prodhim dhe tregtim i energjise elektrike nga burime alternative si parqet e eres, sistemet fotovoltaike, termocentralet, biomasa etj. Kryerja e cdo aktiviteti te nevojshem apo te dobishem per realizimin e qellimeve te saj.	
10. Administratori/ët	Ana Lleshi	
10.1 Afati i emërimit	Nga: 28/04/2017	Deri: 27/04/2027
11. Procedura e emërimit nëse ndryshon nga parashikimet ligjore		



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË
QENDRA KOMBËTARE E BIZNESIT



11.1 Kufizimet e kompetencave (nëse ka)	Administratorja mund të nënshkruaj kontrata, transaksione bankare dhe dokumenta me natyrë financiare me vlerë deri në shumën prej 10 000 (dhjetë mijë) Euro. Për kontrata, transaksione bankare dhe dokumenta me natyrë financiare mbi vlerën 10 000 (dhjetë mijë) Euro, Znj. Ana Lleshi nënshkruan bashkërisht me Ortakun e Vetëm, ose nënshkruan vetëm Znj. Ana Lleshi në bazë të autorizimit paraprak të dhënë me anë të Vendimit të Ortakut të Vetëm të Shoqërisë.	
12. Ortakët	Besnik Leskaj	
12.1 Vlera e kapitalit	Para: 7.000.100,00	Natyre:
12.2 Numri i pjesëve	1,00	
12.3 Pjesëmarrja në përqindje (%)	100,00	
<i>*Të përfaqësuarit, (Plotësohet vetëm nëse një kuotë zotërohet në bashkëpronësi)</i>		
12.4 Komente (nëse ka)		
13. Vende të tjera të ushtrimit të aktivitetit	Tirane Kashar KASHAR Kompleks me 4 (kater) godina banimi dhe shërbimi 9 kate me 2 kate parkim nentoke, Rr. Migjeni, Nj. A. Kashar, Tirane Shqiperi	
14. Të dhëna që njoftohen vullnetarisht	Emri Tregtar: BLESSED INVESTMENT E-Mail: alleshi@blessedinvestment.com Telefon: +355697034789	
15. Statusi:	Aktiv	

Data: 05/06/2023

Emri, Mbiemri, Nënshkrimi
(i nëpunësit të sportelit)



Vulosur elektronikisht nga
Qendra Kombëtare e Biznesit
Date: 2023/06/05 13:59:06 +02:00
L71423028S2023060513585654
2006

Shënim: Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë të një procedure automatike nga një sistem elektronik (Qendra Kombëtare e Biznesit)

LETËRNËFTM ID  REPUBLIKA E SHQIPERISE REPUBLIC OF ALBANIA

 mbiemri/surname
Leskaj
emri/given name
Besnik
shtetësi/nationality
Shqiptare/Albanian
vendlindja/place of birth
Tirane, ALB
data e lindjes/date of birth
30-06-1976
data e tërimit/date of issue
04-04-2017
autoriteti iëshues/authority
MPB

nr. letërnjoftimit/card no.
033356215

 gjinia/sex
M
data e skadimit/date of expiry
03-04-2027
nr. personal/personal no.
H60630112W

firmat/signature


REPUB
ALB

Ana Lleshi ID I15507055G

LETERNJOPTIM ID  REPUBLIKA E SHQIPERISE REPUBLIC OF ALBANIA

 mbiemri/surname
Lleshi
emri/given name
Ana
shprehja/nationality
Shqiptare/Albanian
vendndaj/place of birth
Tirane, ALB
data lindja/date of birth
07-05-1981
data e rishimit/date of issue
02-09-2020
autoriteti i shprehjes/authority
MPB

nr. leternjoptim/card no.
036384557
shprehja
F
data e skadimit/date of expiry
01-09-2030
nr. personal/personal no.
I15507055G


Bema/Signature
Ana Lleshi



REPUBLIC OF ALBANIA

VENDIM
I ORTAKUT TË VETËM TË SHOQËRISË
“MATRIX KONSTRUKSION” SH.P.K.

Sot, më datë 02/06/2023, Ortaku i Vetëm i shoqërisë “MATRIX KONSTRUKSION” SH.P.K., me seli në adresën: Njësia Bashkiake Nr. 7, Rruga “Nikolla Jorga”, Godina Nr. 18/2, Tiranë, me numër unik të identifikimit të subjektit NUIS J91306009Q (në vijim quajtur “Shoqëria”), **Z. Arian Leskaj**, shtetas shqiptar, lindur më 11/04/1968 në Tiranë, mbajtës i letërnjoftimit me Nr. personal G80411135K, merr në shqyrtim dhe vendos për çështjet si më poshtë vijon:

RENDI I DITËS

1. Miratimi i pjesëmarrjes së Shoqërisë në themelimin e një shoqërie tregtare me emërtimin tregtar “ARMEN SOLAR SH.P.K.”.
2. Autorizimi i Administratorit të Shoqërisë Znj. Ida Mezini për të nënshkruar në emër dhe për llogari të Shoqërisë të gjitha aktet e nevojshme për themelimin e shoqërisë tregtare “ARMEN SOLAR SH.P.K.”.

Në përputhje me Statutin e Shoqërisë dhe legjislacionin shqiptar të zbatuar në Republikën e Shqipërisë, në lidhje me rendin e ditës, Ortaku i Vetëm i Shoqërisë me vullnetin e tij të lirë dhe të plotë,

VENDOSI:

1. Të miratojë pjesëmarrjen e Shoqërisë në themelimin e një shoqërie tregtare me emërtimin tregtar “ARMEN SOLAR SH.P.K.”, me ortakë themelues:
 - (i) shoqërinë Matrix Konstruksion Sh.p.k. e cila do të zotërojë 1 (një) kuotë të barabartë me 30% të kapitalit të shoqërisë së re dhe do të shlyhet nëpërmjet kontributit para;
 - (ii) shoqërinë Blessed Investment Sh.p.k. e cila do të zotërojë 1 (një) kuotë të barabartë me 30% të kapitalit të shoqërisë së re dhe do të shlyhet nëpërmjet kontributit para;
 - (iii) Znj. Borana Gusho e cila do të zotërojë 1 (një) kuotë të barabartë me 20% të kapitalit të shoqërisë së re dhe do të shlyhet nëpërmjet kontributit para, dhe
 - (iv) Znj. Vasillo Kuro e cila do të zotërojë 1 (një) kuotë të barabartë me 20% të kapitalit të shoqërisë së re dhe do të shlyhet nëpërmjet kontributit para.

Shoqëria tregtare “ARMEN SOLAR SH.P.K.” do të ketë një kapital themeltar të barabartë me 100,000 Lekë (njëqind mijë lekë).

Shoqëria Matrix Konstruksion Sh.p.k. do të zotërojë një kuotë me vlerë të përgjithshme 30,000 Lekë (tridhjetë mijë lekë) që përbën 30% të kapitalit themeltar të shoqërisë “ARMEN SOLAR SH.P.K.”, të cilën do ta shlyejë në para.



SHAPING LIFE !

Rr. Nikolla Jorga, Godina 18/2, Tiranë | Tel: +355 42 225 83 72
www.matrixkonstruksion.com

Selia e shoqërisë së re “ARMEN SOLAR SH.P.K.” do të jetë: Njësia Bashkiake Nr. 2, Rruga “Themistokli Gërmenji”, Ndërtesa 1, Tiranë, Shqipëri.

Objekti i aktivitetit të shoqërisë së re “ARMEN SOLAR SH.P.K.” do të jetë: “Veprimtari tregtare në fushën e zhvillimit dhe prodhimit të energjisë elektrike nga burimet e rinovueshme, studim, projektim, zbatim, ndërtim, instalim, komisionim, financim, operim, prodhim dhe tregtim i energjisë elektrike nga burime të rinovueshme, si parqet e erës (eolike), ujore, sistemet fotovoltaike, termocentralet, biomasa, etj. dhe infrastrukturat shërbyese. Shoqëria e re ARMEN SOLAR Sh.p.k. mund të kryejë çdo aktivitet të ligjshëm tregëtar që lidhet me çfarëdolloj pasurie të luajtshme dhe/ose të paluajtshme, duke përfshirë por pa u kufizuar vetëm në blerjen, shitjen, transferimin, ndërtimin, nën-kontraktimin, disponimin, posedimin, menaxhimin, marrjen apo dhënien me qira, leasing e pasurive të luajtshme dhe/ose të paluajtshme, dhënien e fitimit e çdo të drejte apo privilegji në lidhje me këto pasuri, dhe çdo aktivitet tjetër tregëtar, financiar, qeraje ose hipoteke, që mund të konsiderohet i vlefshëm ose i nevojshëm në mënyrë që të ushtrohet objekti i shoqërisë.”

Administrator i shoqërisë tregtare “ARMEN SOLAR SH.P.K.” do të jetë Z. Altin Mihali.


2. Të autorizojë Administratorin e Shoqërisë Znj. Ida Mezini të përfaqësojë Shoqërinë në themelimin e shoqërisë tregtare “ARMEN SOLAR SH.P.K.” duke nënshkruar në emër dhe për llogari të Shoqërisë të gjitha aktet e nevojshme dhe/ose të dobishme për themelimin e shoqërisë tregtare “ARMEN SOLAR SH.P.K.”.

Ortaku i Vetëm merr këtë vendim, duke mos patur çështje të tjera për shqyrtim në rendin e ditës.

MATRIX KONSTRUKSION SH.P.K.

Z. Arian LESKAJ

Ortak i Vetëm



SHAPING LIFE !



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË
QENDRA KOMBËTARE E BIZNESIT

**EKSTRAKT I REGJISTRIT TREGTAR PËR TË DHËNAT E
SUBJEKTIT "SHOQËRI ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR"**

GJENDJA E REGJISTRIMIT

1. Numri unik i identifikimit te subjektit (NUIS)	J91306009Q	
2. Data e Regjistrimit	06/01/1999	
3. Emri i Subjektit	Matrix Konstruksion	
4. Forma ligjore	SHPK	
5. Data e themelimit	14/10/1995	
6. Kohëzgjatja	Nga: 14/10/1995	
7. Zyra qendrore e shoqërisë në Shqipëri	Tirane Tirane TIRANE Njesia Bashkiake nr.7, Rruga Nikolla Jorga, Godina Nr.18/2	
8. Kapitali	526.883.471,00	
8.1 Numri i përgjithshëm i kuotave	100,00	
9. Objekti i aktivitetit	Import-eksport,tregtim te mallrave te ndryshme industriale,ushqimore,te materialeve te ndertimit,me shumice e pakice etj.Veprimtari ne fushen e ndertimit e projektimit,restaurimit te objekteve kulturore ose te kultit,veprimtari imobiliare per shitje e blerje,veprimtari ne fushen e turizmit,bar-restorant,hotel.Import-eksport, ne fushen e karburanteve,vajrave lubrifikante etj.Studim, projektim, zbatim, prodhim dhe tregtim I energjise elektrike nga burime alternative si parqet e eres, sistemet fotovoltaike, termocentralet, biomasa etj.	
10. Administratori/ët	Ida Mezini	
10.1 Afati i emërimit	Nga: 29/03/2016	Deri: 26/03/2026
11. Procedura e emërimit nëse ndryshon nga parashikimet ligjore		
11.1 Kufizimet e kompetencave (nëse ka)		
12. Ortakët	ArianLeskaj	
12.1 Vlera e kapitalit	Para: 526.883.471,00	Natyre:



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E FINANCEVE DHE EKONOMISË
QENDRA KOMBËTARE E BIZNESIT

12.2 Numri i pjesëve	100,00
12.3 Pjesëmarrja në përqindje (%)	100,00
<i>*Të përfaqësuarit, (Plotësohet vetëm nëse një kuotë zotërohet në bashkëpronësi)</i>	
12.4 Komente (nëse ka)	
13. Vende të tjera të ushtrimit të aktivitetit	Tirane Kashar YZBERISH Objekti, Kompleks me 4 (kater) godina banimi she sherbimi 9 kate me 2 kat parkim nentoke,Rr. Migjeni, Nj.A. Kashar, Nj.Str.KA/239 Tirane Tirane TIRANE Rruga "Myslym Shyri", Njesia Administratve Nr.10 Fier Fier FIER "Parku Fotovoltaik Blue 2", Bashkia Fier, Sheq Marinas Fier Fier FIER "Parku Fotovoltaik Blue 1", Bashkia Fier, Sheq Marinas
14. Të dhëna që njoftohen vullnetarisht	Emri Tregtar: MATRIX KONSTRUKSION E-Mail: aidamezini@yahoo.it Telefon: 2258372 Të Tjera: Me CN-413472-06-10 bëhet depozitim i vendimit dt.30-05-2009 mbi Autorizimin e Z.Adrian Bedaj për nënshkrimin në çdo bankë brenda territorit të Shqipërisë kontrata të ndryshme huaje,kredie,hipoteke,marrëveshje siguruese etj, në emër të Shoqërisë "MATRIX KONSTRUKSION" duke vënë si garanci pronat e kësaj shoqërie.
15. Statusi:	Aktiv

Datë: 05/06/2023

Emri, Mbiemri, Nënshkrimi
(i nëpunësit të sportelit)



Vulosur elektronikisht nga
Qendra Kombëtare e Biznesit
Date:2023/06/05 13:59:45 +02:00
J91306009Q2023060513593622
2006

2

Shënim : Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë të një procedure automatike nga një sistem elektronik (Qendra Kombëtare e Biznesit)

Arian Leskaj ID Nr. G80411135K

REPUBLIKA E SHQIPERISE REPUBLIC OF ALBANIA

mbiemri/surname
Leskaj
emri/iwan name
Arian
qytetshmëri/nationality
Shqiptare/Albanian
vendndëshja e lindjes
Tiranë, ALB
data e lindjes
11-04-1968
data e hyrjes në vlerë
21-06-2019
autoriteti i emetimit
MPB

034380769
M
20-06-2029
G80411135K

Signature: *[Handwritten Signature]*



Aida Mezini ID Nr. H15724048V



LETËRNJOFITIM ID REPUBLIKA E SHQIPERISE REPUBLIC OF ALBANIA



mbiemri/surname
Gusho
emri/given name
Borana
shtetësia/nationality
Shqiptare/Albanian
vendndija/place of birth
Tiranë, ALB
datëlindja/date of birth
10-06-1984
data e lëshimit/date of issue
07-03-2022
autoriteti lëshues/authority
MPB

nr. letërnjofitim/card no.
038142754
gjinia/sex
F
data e skadimit/date of expiry
06-03-2032
nr. personal/personal no.
I45610083J



firmë/signature
Borana Gusho

REPUB
ALB
TIR

LETËRNJËFTIM ID  REPUBLIKA E SHQIPERISE REPUBLIC OF ALBANIA



mbiemri/surname
Kuro
emri/given name
Vasillo
shqiptarë/nationality
Shqiptare/Albanian
vendndesa/place of birth
Ksamil, ALB
data e lindjes/date of birth
10-11-1962
data e skadencës/date of issue
01-10-2020
firmë/signature
Vasillo Kuro 
autoriteti i shqiptarë/authority
MPB



nr. letërnjësformëcard no.
036473948
gjinia/sex
F
data e skadencës/date of expiry
30-09-2030
nr. personal/personal no.
G26110018G

